

GJYQI SIMULUES G.J.E.D.NJ - SHQIPËRI 2014

KAZUSI

1. Z. Treicy Rony i lindur më 1962 në Merisin është trashëgimtari i vetëm testamentar i babait të tij z. Argo Rony. Pas ndryshimit të sistemit politik në Klismer, në muajin Mars 1994 Z. Treicy iu njoh nga Komisioni i Kthimit të Pronave Merisin e drejta e pronësisë mbi një godinë tre katëshe së bashku me sipërfaqen e oborrit përpara saj, e cila ishte shpronësuar në vitin 1946 nga autoritetet shtetërore dhe kishte shërbyer gjatë viteve të sistemit komunist si kopësht fëmijësh, pozicionuar në bulevardin “Merisin-5”. Prona, që iu njoh z. Rony nga K. K. P Merisin kishte një sipërfaqe prej 1431 m².

2. Z. Rony e përshtati godinën e marrë nga K.K. P Merisin si shtëpi banimi dhe jetoi aty nga viti 1994-1995. Ndërkohë, ai kish nisur një biznes si ndërtues pallatesh në qytetin e Merisinës dhe ishte administrator i vetëm i firmës “N”.

3. Në vitin 1995 z. Treicy vendosi të ndryshonte banesë, duke u strehuar në një artpartament në një nga pallatet e ndërtuara prej tij në Rr. “Anatol”. Në të njëjtën kohë nisi procedurat për të marrë leje ndërtimi për sipërfaqen ku ndodhej prona e tij e kthyer me vendim të K.K. P Merisin. Gjatë kohës, që priste për aprovimin e lejes ai shembi godinën ekzistuese në pronësi të tij.

4. Më 05 janar 1996 Këshilli Bashkiak i Merisinës aprovon lejen e ndërtimit në favor të firmës “N” për ndërtimin e një pallati 15 kate të lartë dhe me 4 kate nëntokë. Menjëherë pas aprovimit të lejes firma e ndërtimit z. Rony nisi punimet për ndërtimin e pallatit në 10 shkurt 2001.

5. Në Qershor 2001 Policia Ndërtimore e Merisinës njoftoi z. Treicy Rony administrator i firmës “N” për pezullimin e përkohshëm të punimeve në sheshin e ndërtimit pranë Autoritetit Portual Merisin, me arsyetimin se do të verifikoheshin dokumentat e lejes së ndërtimit.

6. Në 15 Shtator të po atij viti Inspektoriati Ndërtimor i Merisinës pas kontrolleve të dokumentacionit vlerësoi se leja e ndërtimit dhënë nga Këshilli Bashkiak i Merisinës më 05 janar 1996 ishte e pavlefshme, për këtë arsye u vendos pezullimi i ndërtimeve të pallatit dhe një gjobë për firmën ndërtuese 1,000,000 korona.

7. Pas ezaurimit të të gjithë procedurave të apelimit administrativ, Administratori i firmës “N” ngriti padi më datë 03 prill 2002 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Merisin, për pavlefshmërinë e vendimit të Inspektoriatit Ndërtimor.

8. Më 07 tetor 2002 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Merisin, vendosi rrëzimin e kërkesë-padisë së Firmës së ndërtimit “N”, duke lënë në fuqi vendimin e Inspektoriatit Ndërtimor.

9. Dhjetë ditë pas kësaj më datë 17 tetor 2002 paditësi bëri apel pranë Gjykatës së Apelit Merisin, e cila më datë 15 shkurt 2003 aprovoi argumentet e apelit dhe vendosi, që të anulohet vendimi i Inspektoriatit Ndërtimor dhe të rifillonte puna për ndërtimin e pallatit, duke e cilësuar lejen e ndërtimit të vlefshme.

10. Inspektoriat Ndërtimor Merisin, bëri rekurs në Gjykatën e Lartë, për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Apelit. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë më 16 shkurt 2003 vendosi të kthente çështjen për rigjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Merisin, me një tjetër trup gjykues, me argumentin se gjatë gjykimit të çështjes nuk ishin respektuar procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile.

11. Më 04 prill 2003 kur çështja kishte nisur të gjykohej përsëri nga Gjykata e Rrethit Merisin ndërhyr në proces z. F. në cilësinë e personit të tretë. Z. F. shtetas klismerjan dhe francez lindur në Merisin më 1952 banonte në Nicë prej shkurtit të vitit 1993.

12. Z. F. ish-drejtor i kopshtit të fëmijëve ngriti pretendimin se trualli objekt gjykimi ishte në pronësi të tij, vërtetuar kjo me kontratën e privatizimit lidhur mes tij dhe Agjencisë Kombëtare të Privatizimit më datë 07 janar 1993. Ai argumentoi gjithashtu se nuk kishte pasur mundësi objektive të ndërhynte më shpejt në procesin gjyqësor për arsye se ndodhej jashtë shtetit.

13. Në vendimin e saj marrë në datë 25 shtator 2003 Gjykata e Rrethit u shpreh se leja e ndërtimit e dhënë në favor të firmës “N” ishte e pavlefshme dhe urdhëroi që punimet të mos vazhdonin. Në lidhje me kërkesën e personit të tretë, Gjykata u mjaftua me argumentimin se ai nuk kish zbatuar dispozitat procedurale të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile për ndërhyrësit në një proces gjyqësor civil.

14. Administratori i firmës “N” bëri përsëri ankim në Gjykatën e Apelit Merisin, e cila më datë 20 mars 2004 vendosi, që leja e ndërtimit dhënë për firmën “N” ishte e rregullt dhe në përputhje me kriteret ligjore. Gjykata u shpreh se punimet në sheshin e ndërtimit mund të nisnin përsëri. Ndërkohë, në lidhje me pretendimet e personit të tretë z. F., Gjykata vendosi se kontrata mes tij dhe Agjencisë së Privatizimit ishte absolutisht e pavlefshme, sepse ishte nënshkruar në kundërshtim me ligjin.

15. Në 3 prill 2004 Firma “N” vijoi me ndërtimin e pallatit. Më datë 10 prill 2004 Policia Ndërtimore, e asistuar nga Policia e Shtetit u paraqit në ambientet e zyrave të firmës “N” dhe kërkoi inspektimin e kompjuterave dhe dosjeve të kompanisë. Në këto kushte juristi i kompanisë X.S. kërkoi autorizimin e gjykatës për kontrollin fizik të ambienteve të zyrës. Ai së bashku me financierin Y.K., u munduan të mos lejonin policët të bënin kontroll, me arsyen se ata nuk paraqitën autorizimin e kërkuar.

16. Policia me pretendimin se financieri dhe juristi i firmës kundërshtuan kryerjen e detyrës së punonjësve të policisë, u arrestuan dhe për këtë Gjykata e Rrethit Merisin me kërkesë të prokurorisë zhvilloi një seancë për vleftësimin e masës së sigurimit.

17. Dy personat e arrestuar nga Policia u shoqëruan në ambientet e gjykatës të prangosur dhe qëndruan brenda kafazit të hekurt.

18. Me datë 11 Prill 2004 Gjykata e miratoi kërkesën e prokurorisë për masën e sigurimit personal arrest me burg, duke argumentuar se pretendimet e policisë ishin të bazuara.

19. Me datë 21 prill 2004 gjykata mori përsëri në shqyrtim masën e arrestit me burg ndaj të pandehurve X.S. dhe Y.K. dhe vendosi ta shtyjë afatin e masës arrest me burg deri më datë 09 qershor 2004, duke u mbështetur në të njëjtat arsye si në vendimin e saj datë 11 prill 2004. Ajo e zgjati edhe tre herë të tjera masën me burg përkatësisht deri më 30 korrik 2004, 30 tetor 2004, 22 qershor 2005. Në seancat e zgjatjes së masës as të pandehurit dhe as avokatët e tyre nuk janë të pranishëm përderisa gjykata vlerësoi se ata i kanë paraqitur argumentet e tyre në seancën kur u vendos fillimisht masa e arrestit me burg. Pas rreth 16 muajsh të pandehurit vazhdojnë të jenë të burg.

20. Më datë 15 tetor 2004 prokuroria e paraqiti çështjen në gjykatë me akuzën se të pandehurit kishin kundërshtuar veprimet e policisë dhe se kishin filluar një ndërtim pa leje. Pas 12 seancash që kanë zgjatur 8 muaj gjykata e shkallës së parë nuk është shprehur ende për fajësinë e tyre. 4 seanca janë shtyrë nga mos prania e prokurorëve, 3 sepse gjyqtarja ishte e sëmurë, një sepse gjyqtarja po merrte pjesë në një gjykim tjetër dhe 2 seanca u shtynë për shkak të mospranisë së avokatëve të të pandehurve.

21. Kundër vendimit të apelit për vlefshmëri të lejes së ndërtimit, më 15 shtator 2004 bënë rekurs Inspektoriati Ndërtimor dhe personi i tretë z. F. pranë Gjykatës së Lartë. Gjykata e Lartë më 10 shkurt 2005 ka shpallur lejen e ndërtimit të pavlefshme, duke prishur kështu vendimin e Gjykatës së Apelit dhe duke i`a kthyer edhe një herë për rigjykim çështjen në apel. Pas vendimit të Gjykatës së Apelit të 20 prill 2005, e cila vendosi që çështja duhet të rikthehej për rigjykim në themel në Gjykatën e Rrethit të dy palët iu drejtuan përsëri Gjykatës së Lartë, e cila në formacion të plotë ku morën pjesë të gjithë anëtarët e saj (ndërmjet të cilëve edhe gjyqtarët JL, SR, dhe ËO që kishin marrë pjesë në vendimin e datës 10 shkurt 2005) vendosi të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ndërkohë, për pretendimet e ngritura nga z. F., Gjykata e Lartë nuk u shpreh.

20. Ndërkohë Inspektoriati i Ndërtimit nuk lejon vazhdimin e punimeve në sheshin e ndërtimit.

21. Pas vendimit të Gjykatës së Lartë, z. F. vuri në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke ju referuar nenit 131 (f) të Kushtetutës së Republikës së Klismer-it.

22. Tre anëtare të GJK u tërhoqën nga gjykimi i çështjes pasi dy prej tyre kishin qenë avokatë të firmës "N", kurse i treti sepse kishte marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë. 6 gjyqtarët e mbetur morën në shqyrtim kërkesën e z. F. Pas shqyrtimit gjyqësor ata u ndanë në 3 në favor të pranimit të saj dhe 3 kundër. Në këto kushte, përderisa nuk ishte arritur një shumicë, Gjykata Kushtetuese në bazë të nenit 73 për organizimin e saj, vendosi të shtyjë votimin për kërkesën.